



Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike

Prishtinë, 15.07.2026

PËR: Këshillin e Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (përmes Dekanatit)

NGA: Prof. Dr. Blerim Rexha - Kryetar i Komisionit për shqyrtimin e ankesave, i emëruar me Vendimin nr. 2888/26, dt. 23.06.2026

RAPORT

për shqyrtimin e ankesave kundër Rezultateve preliminare të konkursit për studimet e doktoratës në FIEK, të datës 07.07.2026 (nr. prot. 3125/26) — mendim i ndarë i kryetarit të komisionit

I. MANDATI DHE PROCEDURA

Komisioni për shqyrtimin e ankesave është emëruar me Vendimin nr. 2888/26 të datës 23.06.2026, në përbërje: Prof. Dr. Blerim Rexha (kryetar), Prof. Dr. Sabrije Osmanaj (anëtare) dhe Prof. Dr. Mimoza Ibrani (anëtare), me detyrë shqyrtimin e ankesave të kandidatëve lidhur me mospranimin në studimet e doktoratës në FIEK për vitin akademik 2026/2027. Brenda afatit të përcaktuar në pikën IV të Konkursit (09–10.07.2026), në arkivën e fakultetit janë protokolluar shtatë (7) ankesa kundër Rezultateve preliminare të datës 07.07.2026. Sipas dokumentacionit zyrtar të vlerësimit, në program kanë aplikuar 12 kandidatë, prej të cilëve vetëm 3 janë ftuar në intervistë dhe janë ranguar; të gjithë ankuesit e tejkalojnë dukshëm pragun minimal të notës mesatare 8.00 (neni 9, pika 3 e Rregullores):

Në Rezultatet preliminare, arsyet e mosrangimit të kandidatëve janë shënuar me referencat K1, K2 dhe K3. Sipas përkufizimit të dhënë në vetë vendimin e Komisionit për pranim, këto kritere kanë këtë kuptim:

K1 — Fusha e studimeve paraprake (neni 10, pika 5.1 e Rregullores): kandidati duhet t'i ketë të përfunduara studimet paraprake bachelor dhe master në fushën e njëjtë ose të afërt me programin e doktoratës. Komisioni për pranim e ka zbatuar këtë kriter duke u mbështetur në konstatimin e Këshillit të Studimeve të Doktoratës në FIEK, të datës 03.07.2026, të marrë me shumicë votash, se kandidatët përkatës nuk konsiderohen se i kanë përfunduar studimet paraprake në Inxhinieri Elektrike dhe Kompjuterike;

K2 — Njohuritë e gjuhës angleze (neni 10, pika 8 e Rregullores): kandidati duhet të dëshmojë njohuri të gjuhës angleze së paku në nivelin B2, përkatësisht së paku 72 pikë në TOEFL iBT ose 5.5 në IELTS. Ky kriter nuk është objekt i asnjërës prej shtatë ankesave të pranuar;

K3 — Letra e zotimit nga mentori potencial (neni 9, pika 5 e Rregullores; pika I.3 e Konkursit): kandidati duhet të dorëzojë letër zotimi apo konfirmim të një profesori të fushës përkatëse, i cili është i gatshëm ta mentorojë kandidatin (**mentor potencial**) dhe i cili i plotëson kushtet për mentorim. Komisioni për pranim e ka zbatuar këtë kriter duke u mbështetur në listën e mentorëve potencialë, të pranuar nga Dekanati i FIEK-ut më datë 03.07.2026.

Gjendja e ankesave të protoklluara është si në tabelen vijuese:

#	Ankuesi/ja (renditja alfabetike)	ID e dosjes	Nr. prot.	Kriteret e kontestuar
1.	Alketa Sahiti	100009	3249/26	K3
2.	Alma Novobërdaliu	nr. pers. ***567	3146/26	K1 (bachelor dhe master)
3.	Ariana Kadriu	nr. pers. ***803	3228/26	K1 (bachelor) dhe K3
4.	Arlinda Sheholli Prekadini	100007	3128/26	K3
5.	Eliona Aliju Ballazhi	100001	3462/26	K1 (master);
6.	Ilir Osmanaj	100002	3172/26	K1 (master) dhe K3
7.	Kastriot Fetahaj	100003	3241/26	K1 (master) dhe K3

II. DEKLARIMI I KONFLIKTIT TË INTERESIT

Në pajtim me pikën I.12 të Konkursit dhe me parimin e objektivitetit dhe paanësisë (neni 7 i Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në tekstin e mëtejme: LPPA), deklaroj se kam lëshuar letrat e zotimit si mentor potencial për kandidatët e dosjeve 100002 (Ilir Osmanaj), 100003 (Kastriot Fetahaj) dhe 100007 (Arlinda Sheholli Prekadini). Këto letra i kam lëshuar në fazën e aplikimit, pa e ditur dhe pa pasur mundësi ta dija numrin e përgjithshëm të kandidatëve aplikues, dhe duke qenë i vetëdijshëm se procedura është konkurruese — pra pa paragjykuar se të gjithë kandidatët do të pranohen (shih arsyetimin në pikën V.1). Për këtë arsye, gjetjet e këtij raporti janë formuluar si konstatime procedurale, të zbatueshme njësoj për të gjithë kandidatët, pavarësisht identitetit të mentorit potencial. Për vlerësimin individual dhe votimin lidhur me këto tri dosje (ankesa), i rekomandoj Këshillit të Fakultetit që vendimmarrja të mbështetet pa pjesëmarrjen time.

III. MBLEDHJA E KOMISIONIT DHE MENDIMI I NDARË

Komisioni për shqyrtimin e ankesave është mbledhur më datë 14.07.2026 dhe i ka shqyrtuar të gjitha, shtatë, ankesat. Pas diskutimit, komisioni nuk ka arritur konsensus lidhur me mënyrën e zgjidhjes së tyre. Në pamundësi të një qëndrimi unik dhe në përmbushje të detyrimit për raportim ndaj Këshillit të Fakultetit brenda afateve të Konkursit (pika IV, shkronja d), unë, si kryetar i komisionit, e paraqes këtë raport si mendim të ndarë, me arsyetimin dhe rekomandimet si më poshtë. Anëtarët e komisionit kanë mundësinë t'ia paraqesin Këshillit qëndrimet e tyre ndaras, në mënyrë që Këshilli të vendosë duke i pasur para vetes të gjitha argumentet.

IV. BAZA LIGJORE

Ky raport mbështetet në: Konkursin për pranimin e studentëve në studimet e doktoratës 2026/2027, nr. prot. 1/345, dt. 07.05.2026 (pikat I.3, I.7.1, I.11, I.12 dhe IV); Rregulloren e Përgjithshme për Studime të Doktoratës nr. 1/147, dt. 16.04.2026 (neni 9 pika 3, neni 10 pikat 4 dhe 5.1, neni 11 pikat 7–8, neni 12, neni 35); Statutin e Universitetit të Prishtinës (neni 98 par. 3, neni 100, neni 105); Ligjin nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (nenet 4, 5, 6, 7, 8, 9, 11, 13, 48 dhe 134); si dhe standardet dhe praktikat evropiane e ndërkombëtare të përshkuara në pikën V.5, me referencat e plota në pikën VIII.

V. GJETJET E PËRGJITHSHME

V.1. Kriteri K3 është zbatuar mbi bazën e një liste të krijuar pas mbylljes së konkursit

Vendimi i kontestuar mbështetet në “njoftimin për listën e mentorëve potencialë, të pranuar nga Dekanati i FIEK-ut më datë 03.07.2026”. Rregullorja (neni 10, pika 4) përcakton se njësitë akademike, **së bashku me kërkesën për konkurs**, duhet ta dërgojnë edhe listën e mentorëve që i plotësojnë kushtet për mentorim — pra lista është dashur të ekzistojë para publikimit të konkursit më 07.05.2026, e jo të pranohet shtatë ditë pas mbylljes së afatit të aplikimit (26.06.2026). Asnjë kandidat nuk ka pasur mundësi objektive të dijë, në momentin e aplikimit, se cilët profesorë do të figuronin në një listë të hartuar pas afatit, aq më tepër që lista nuk ishte publike as gjatë aplikimit dhe as pas shpalljes së rezultateve. Zbatimi retroaktiv i saj si kriter eliminues cenon parimin e ligjshmërisë (neni 4 i LPPA-së), parimin e pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme (neni 8 i LPPA-së) dhe parimin e administratës së hapur (neni 9 i LPPA-së). Nga dokumentacioni zyrtar i vlerësimit rezulton se të gjithë ankuesit i kishin dorëzuar letrat e zotimit me dosjen e aplikimit.

Asnjë dispozitë e Rregullores apo e Konkursit nuk parasheh që kandidati përjashtohet nga procedura e pranimit për shkak se mentor i potencial e ka arritur kufirin e nenit 12, pika 5. Sipas nenit 11, pikat 7 dhe 8 të Rregullores, doktoranti e propozon temën dhe mentorin potencial (Formulari F1) në fillim të semestrit të dytë, ndërsa mentor i zyrtar caktohet nga Senati pas vlerësimit pozitiv të projekt-propozimit (Formulari F2). Në fazën e aplikimit kërkohet vetëm letër zotimi e një mentor i potencial (pika I.3 e Konkursit); përmbushja e kufirit të mentorimit vlerësohet, pra, në momentin e caktimit zyrtar — rreth një vit pas aplikimit — sepse **edhe kapacitetet mentoruese janë kategori dinamike (doktorantë që mbrojnë temat, mentorë të rinj që kualifikohen).**

Letra e zotimit ka natyrë të kushtëzuar dhe jo-ekskluzive. Ajo lëshohet në fazën e aplikimit, kur profesori nuk e di dhe nuk mund ta dijë numrin e përgjithshëm të kandidatëve që aplikojnë në konkurs, e as rezultatin e procedurës konkurruese. Zotimi shpreh vetëm gatishmërinë e mentorit potencial për ta mentoruar kandidatin nëse ky pranohet përmes vlerësimit meritore — ai nuk paragjykon pranimin e të gjithë kandidatëve dhe nuk krijon detyrim të njëkohshëm mentorimi për të gjithë. Rrjedhimisht, interpretimi që e barazon numrin e letrave të lëshuara nga një profesor me numrin e doktorantëve të marrë njëkohësisht në udhëheqje është i pasaktë në thelb: nga kandidatët që mbajnë letra të të njëjtit mentor potencial, disa mund të mos pranohen fare në procedurën konkurruese, ndërsa caktimi zyrtar i mentorit për të pranuarit bëhet rreth një vit pas aplikimit (neni 11, pikat 7–8), kur kapacitetet mentoruese janë kategori dinamike — doktorantët ekzistues mbrojnë temat, ndërsa mentorë të rinj kualifikohen.

V.2. Kriteri K1 është zbatuar pa fusha të afërta të publikuara dhe mbi bazën e një vendimi interpretues të marrë pas afatit

Neni 10, pika 5.1 e Rregullores dhe pika I.7.1 e Konkursit kërkojnë shprehimisht që fushat e afërta të përcaktohen nga njësitë akademike, të vlejnjë për tërë periudhën e akreditimit dhe **të publikohen në konkurs**. Në kushtet e veçanta të FIEK-ut nuk është publikuar asnjë listë e fushave të afërta dhe asnjë kriter operacional. Vendimi i Këshillit të Studimeve të Doktoratës i datës 03.07.2026, i marrë

me shumicë votash një javë pas mbylljes së afatit, e ka përcaktuar përmbajtjen e kriterit K1 në mënyrë ad hoc dhe retroaktive — në kundërshtim me kërkesën për përcaktim paraprak dhe me nenin 8 të LPPA-së — dhe pa asnjë arsytim metodologjik të krahasimit të përmbajtjes së programeve, në kundërshtim me nenin 48 të LPPA-së.

Krahas kësaj, dispozita e pikës 5.1 gjendet sistematikisht nën titullin **“Kriteret e përcaktimit të përparësisë në radhitjen e kandidatëve”** — pra është kriter renditjeje me përparësi, jo kriter absolut eliminues. Statuti i UP-së (neni 100, par. 2) ua njeh të drejtën e konkurrit në studimet e doktoratës të gjithë të diplomuarve me titull master në vlerën 300 ECTS, pa kufizim fushe në nivel statuti. Diplomat e programeve të akredituara nga AKA — përfshirë ato të institucioneve jopublike — janë juridikisht të barasvlershme sipas Ligjit për Arsimin e Lartë; aty ku Universiteti ka dashur të vendosë kufizim ndaj institucioneve jopublike, e ka bërë shprehimisht (kushtet e veçanta të Fakultetit të Edukimit), çka dëshmon se për FIEK-un një kufizim i tillë nuk ekziston.

V.3. Mohimi i fazës së intervistimit dhe mungesa e arsytimit

Nëntë nga dymbëdhjetë kandidatët nuk janë ftuar fare në intervistë dhe në prezantimin e konceptit ideor, edhe pse Rregullorja (neni 10, pika 1) dhe Konkursi (pikat I.4–I.6) e parashohin këtë si pjesë të detyrueshme të vlerësimit meritot (deri në 40 + 20 pikë). Arsytimi i dhënë në rezultatet preliminare — si “Nuk plotësohet kriteri K1/K3” — nuk i përmbush kërkesat e nenit 48 të LPPA-së për arsytimin e aktit administrativ; sipas paragrafit 2 të po atij neni, një arsytim dukshëm i pamjaftueshëm barazohet me mungesën e tij. Vendimi që do ta zgjidhë ankesën duhet, sipas nenit 134 të LPPA-së, t’i vlerësojë të gjitha pretendimet e parashtruara.

V.4. Proporcionaliteti dhe vendet e paplotësuara

Konkursi parasheh për programin “Doktoratë në Inxhinieri Elektrike dhe Kompjuterike” 12 vende (11 të rregullta + 1 nga komunitetet joshumicë). Kanë aplikuar 12 kandidatë; janë ranguar vetëm 3 — pra kanë mbetur **9 vende të paplotësuara**, ndërkohë që 9 kandidatë janë përjashtuar pa asnjë vlerësim meritot. Në këto rrethana nuk ekziston asnjë konkurrencë për vende të kufizuara që do ta justifikonte një lexim maksimalisht përjashtues të kriterëve. Zbatimi eliminues i një kriteri përparësie, kur shumica e vendeve mbeten të lira, bie ndesh me parimin e proporcionalitetit (neni 5 i LPPA-së) dhe me interesin institucional të fakultetit për t’i shfrytëzuar kapacitetet e akredituara.

V.5. Standardet dhe praktikat Europiane e ndërkombëtare për fushën e studimeve paraprake

Dokumentet themelore Europiane për studimet e doktoratës — drejt të cilave UP-ja synon të konvergjojë — e trajtojnë pranimin si proces transparent, meritot dhe me kritere të shpallura paraprakisht. **Parimet e Salzburgut (EUA, 2005) dhe Rekomandimet Salzburg II (EUA, 2010)** [1][2] kërkojnë që universitetet të rekrutojnë kandidatë përmes procedurave transparente dhe të llogaridhënshme dhe e theksojnë pasurimin e mjediseve kërkimore me kandidatë të profileve të ndryshme. **Parimet e BE-së për Trajnimin Inovativ të Doktoratës (Komisioni Evropian, 2011)** [3] e vendosin ndërdisiplinaritetin ndër shtatë parimet bazë: mjediset doktorale duhet të jenë të hapura ndaj kandidatëve që vijnë nga fusha të afërta dhe ndërdisiplinore, e jo të mbyllura pas emërtimeve formale të diplomave.

Karta Europiane e Studiuesve dhe Kodi i Sjelljes për Rekrutimin e Studiuesve (Komisioni Evropian, 2005) [4] — të cilëve u referohet politika e rekrutimit të hapur, transparent dhe meritore, kërkojnë shprehimisht që merita të vlerësohet në mënyrë cilësore e të gjithanshme, jo vetëm përmes krahasimit formal të kualifikimeve, dhe që kriteret e përzgjedhjes të shpallen paraprakisht. **Konventa e Lisbonës për Njohjen e Kualifikimeve (Këshilli i Evropës/UNESCO, 1997, ETS nr. 165) [5]**, standard i cili zbatohet edhe në legjislacionin e arsimit të lartë të Kosovës, e vendos barrën e provës tek institucioni: kualifikimi i huaj njihet, përveç nëse institucioni dëshmon me arsyetim “dallim substancial” — dhe vendimi duhet të jetë i arsyetuar e i ankimueshëm.

Në praktikën e universiteteve europiane, afërsia e fushës vlerësohet me analizë përmbajtjesore të kurrikulës (lëndët, ECTS-të, rezultatet e të nxënësve) dhe me vendim individual të arsyetuar — jo me krahasim tekstual të emërimit të diplomës. Një kandidat me master në shkenca kompjuterike, data science, energji elektrike apo informatikë inxhinierike do të konsiderohej, sipas këtyre standardeve, qartazi brenda ose në fushë të afërt me një program doktorate në inxhinieri elektrike dhe kompjuterike. Leximi i ngushtë i zbatuar në rezultatet preliminare largohet nga këto standarde dhe nga praktika e mirë europiane.

VI. VLERËSIMI INDIVIDUAL I ANKESAVE (sipas rendit alfabetik të emrit)

VI.1. Alketa Sahiti (dosja 100009)

Refuzuar vetëm për K3 (Letra e zotimit nga mentori potencial) — asnjë kriter tjetër nuk i është kontestuar (nota mesatare 8.26/9.23; dokumentacioni i kompletuar sipas tabelës zyrtare të vlerësimit). Vlejnë tërësisht gjetjet e pikës V.1: lista e mentorëve potencialë është pranuar nga Dekanati më 03.07.2026, pas mbylljes së afatit, nuk ka qenë e publikuar gjatë aplikimit dhe nuk është publike as tani — çka e bën të pamundur verifikimin paraprak nga kandidatët dhe cenon transparencën (neni 9 i LPPA-së). Kandidatja ka kërkuar me të drejtë qasje në listë dhe arsyetim të detajuar; këto kërkesa mbështeten drejtpërdrejt në nenet 9, 11 dhe 48 të LPPA-së.

Rekomandimi: ankesa të aprovohet, kandidatja të ftohet në fazën e intervistimit dhe të prezantimit të konceptit ideor.

VI.2. Alma Novobërdaliu (nr. personal *567, nr. prot. 3146/26)**

Refuzuar vetëm mbi bazën e K1 (Fusha e studimeve paraprake: bachelor dhe master), pa asnjë kriter tjetër të kontestuar. Studimet bachelor dhe master i ka përfunduar në fushën “Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri” në UBT (programe të akredituara), me notë mesatare 9.42 dhe 9.59 — mesatarja e përgjithshme 9.505, dukshëm mbi pragun 8.00 — me dëshmi për sukses të jashtëzakonshëm (studente e dalluar, bursiste). Ankesa e saj parashton saktë se pika 5.1 e nenit 10 është kriter përparësie në radhitje, jo kriter eliminues (V.2), se fushat e afërta nuk janë publikuar dhe se konstatimi “me shumicë votash” i datës 03.07.2026 nuk përmban asnjë arsyetim metodologjik të krahasimit të kurrikulave (neni 48 i LPPA-së). Përgjithësisht i saj pa asnjë vlerësim meritore, kur kanë mbetur 9 vende të lira, është qartazi joproporcional (V.4).

Rekomandimi: ankesa të aprovohet; kandidatja të ftohet në fazën e intervistimit dhe të prezantimit të konceptit ideor, me vlerësim të plotë meritore.

VI.3. Ariana Kadriu (nr. personal *803, nr. prot. 3228/26)**

Refuzuar për K1 (Fusha e studimeve paraprake: bachelor) dhe K3 (Letra e zotimit nga mentori potencial). Studimet bachelor i ka përfunduar në programin Informatikë Inxhinierike në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë — fushë dukshëm e afërt me inxhinierinë kompjuterike — ndërsa master e ka përfunduar pikërisht në FIEK, në programin Inxhinieri Kompjuterike dhe Softuerike, me notë mesatare 9.57. Formimi i saj, i parë në tërësi, është brenda fushës së programit; kontestimi vetëm i nivelit bachelor për një kandidate me master të vetë njësisë akademike është joproporcional. Për K3, kandidatja ka vepruar në mirëbesim dhe ka ofruar zgjidhje konstruktive: dorëzimin e një letre të re zotimi nga mentor tjetër potencial. Pranimi i kësaj zgjidhjeje është masa më e butë e mundshme (neni 5 i LPPA-së) që e ruan qëllimin e kriterit pa e eliminuar kandidaten për rrethanë jashtë kontrollit të saj.

Rekomandimi: ankesa të aprovohet; t’i mundësohet dorëzimi i letrës së re të zotimit dhe kandidatja të ftohet në fazën e intervistimit dhe të prezantimit të konceptit ideor.

VI.4. Arlinda Sheholli Prekadini (dosja 100007, nr. prot. 3128/26)

Refuzuar vetëm për K3 (Letra e zotimit nga mentori potencial). Studimet bachelor (9.23) dhe master (9.06) i ka përfunduar në vetë FIEK-un — mesatarja 9.14, dukshëm mbi pragun minimal — ka punim shkencor të publikuar dhe koncept ideor në fushën e sigurisë së Large Language Model Agents. Letra e zotimit është dorëzuar në përputhje me kërkesat e Konkursit. Vlejnë gjetjet e pikës V.1: asnjë dispozitë nuk parasheh përjashtimin e kandidatit për shkak të kufirit të mentorit potencial, i cili vlerësohet në momentin e caktimit zyrtar (neni 11, pikat 7–8). Ankesa dokumenton edhe rrethanën se një doktorante aktuale e mentorit potencial e ka dorëzuar punimin e doktoratës më 22.06.2026 — para mbylljes së konkursit — çka konfirmon natyrën dinamike të kapaciteteve mentoruese deri në momentin relevant të vlerësimit.

Rekomandimi: ankesa të aprovohet; kandidatja të ftohet në fazën e intervistimit dhe të prezantimit të konceptit ideor.

VI.5. Eliona Aliju Ballazhi (dosja 100001, nr. prot. 3462/26)

Refuzuar për K1 (Fusha e studimeve paraprake: master). Kandidatja ka dorëzuar dosjen fizikisht më 23.06.2026, por nuk i është caktuar dhe komunikuar ID-ja e aplikimit — nga dokumentacioni i vlerësimit rezulton se dosja e saj mban numrin 100001, të cilin kandidatja nuk e ka ditur. Kjo e ka penguar të verifikojë rezultatin e vet dhe e cenon të drejtën për mjete juridike efektive (neni 13 i LPPA-së), detyrimin e informimit aktiv (neni 11 i LPPA-së) dhe trajtimin e barabartë në identifikim (neni 6 i LPPA-së). Në merita: studimet bachelor i ka përfunduar në UP (8.74) — nivel i pranuar nga komisioni — ndërsa master i shkencës në “Energji Elektrike dhe Tregjet e Energjisë” në Kolegjin UBT (9.47), program i akredituar; është inxhinier e licencuar e kategorisë A nga Oda e Inxhinierëve të Kosovës. Fusha e energjisë elektrike është në thelb të emërtimit të vetë programit të doktoratës (“Inxhinieri Elektrike...”). Pranimi i nivelit bachelor dhe refuzimi i nivelit master me të njëjtin kriter dëshmon zbatim kundërtëhënës.

Rekomandimi: kandidates t'i komunikohet zyrtarisht ID-ja e dosjes (100001); të bëhet vlerësim i arsyetuar i afërsisë së programit master; ankesa të aprovohet dhe kandidatja të ftohet në fazën e intervistimit dhe të prezantimit të konceptit ideor.

VI.6. Ilir Osmanaj (dosja 100002, nr. prot. 3172/26)

Refuzuar për K1 (Fusha e studimeve paraprake: master) dhe K3 (Letra e zotimit nga mentori potencial). Studimet bachelor i ka përfunduar në vetë FIEK-un, në drejtimin Inxhinieri Kompjuterike (8.66), ndërsa master në programin Data Science në Universitetin Teknik të Vjenës (TU Wien) — universitet publik ndërkombëtarisht i njohur — me gradën Diplom-Ingenieur (120 ECTS), të barasvlershme me MSc. Kurrikula e dorëzuar me ankesë dëshmon mbivendosje të drejtpërdrejtë lëndore me programin e FIEK-ut dhe thellim pikërisht në fushat kërkimore bashkëkohore të inxhinierisë kompjuterike (Inteligjenca Artificiale). Procedura e njohjes së diplomës së huaj (pika III.3 e Konkursit) është në proces sipas evidencës së vlerësimit dhe përbën veprim formalo-administrativ të ndarë nga çështja përmbajtjesore e afërsisë së fushës. Sipas standardit të Konventës së Lisbonës (pika V.5), kualifikimi i huaj njihet përveç nëse dëshmohet me arsyetim dallim substancial — gjë që nuk ka ndodhur. Për K3 vlejnjë gjetjet e pikës V.1.

Rekomandimi: ankesa të aprovohet; kandidati të ftohet në fazën e intervistimit dhe të prezantimit të konceptit ideor; njohja e diplomës të përcillet paralelisht sipas procedurës statutare.

VI.7. Kastriot Fetahaj (dosja 100003, nr. prot. 3241/26)

Refuzuar për K1 (Fusha e studimeve paraprake: master) dhe K3 (Letra e zotimit nga mentori potencial). Studimet bachelor i ka përfunduar në vetë FIEK-un (8.13) — rrethanë e pakontestuar — ndërsa master në Shkenca Kompjuterike në Kolegjin AAB, program i akredituar nga AKA, me notë mesatare maksimale 10.00. Shkencat kompjuterike janë brenda, ose së paku fushë e afërt e, Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike; programi i doktoratës e mban në emërtim vetë fjalën “Kompjuterike”. Në mungesë të fushave të afërta të publikuara, refuzimi mbështetet në kriter të pashpallur (V.2). Kufizimi ndaj institucioneve jopublike ekziston vetëm te Fakulteti i Edukimit — jo te FIEK-u. Për K3 vlejnjë gjetjet e pikës V.1: letra e zotimit është dorëzuar e rregullt dhe lista e datës 03.07.2026 nuk mund të zbatohet retroaktivisht.

Rekomandimi: ankesa të aprovohet; kandidati të ftohet në fazën e intervistimit dhe të prezantimit të konceptit ideor, me vlerësim të plotë meritior.

VII. REKOMANDIMET PËR KËSHILLIN E FAKULTETIT

Mbi bazën e gjetjeve të mësipërme, i rekomandoj Këshillit të Fakultetit:

1. Të konstatojë se zbatimi i kriterëve K1 dhe K3 si kriterë eliminuese, mbi bazën e vendimit interpretues të KSD-së dhe të listës së mentorëve të datës 03.07.2026 — të dyja të krijuara pas mbylljes së afatit të aplikimit — përbën shkelje procedurale të Rregullores nr. 1/147, të Konkursit dhe të neneve 4, 8 dhe 9 të LPPA-së;
2. T'i aprovojë të shtatë ankesat dhe t'i ftojë kandidatët në fazën e intervistimit/testimit dhe të prezantimit të konceptit ideor, me vlerësim të plotë meritior sipas nenit 10 të Rregullores dhe pikave I.4–I.7 të Konkursit, duke pasur parasysh se 9 nga 12 vendet e programit kanë mbetur të paplotësuara;
3. Për znj. Aliju Ballazhi — t'i komunikohet zyrtarisht ID-ja e dosjes së saj (100001); për znj. Kadriu — të lejohet dorëzimi i letrës së re të zotimit nga mentor tjetër potencial;
4. Lista e rishikuar e kandidatëve të propozuar t'i dërgohet KQSD-së brenda afatit të pikës IV.d të Konkursit (15.07.2026), duke e njoftuar KQSD-në dhe Senatin edhe për këtë raport dhe për mungesën e konsensusit brenda komisionit;
5. Në rast të refuzimit të ndonjë ankese, vendimi të arsyetohet me shkrim sipas neneve 48 dhe 134 të LPPA-së — duke iu përgjigjur secilit pretendim — dhe të përmbajë këshillën juridike për të drejtën e apelimit në KQSD sipas nenit 35 të Rregullores;
6. Për konkurset e ardhshme: fushat e afërta të përcaktohen dhe të publikohen në konkurs (neni 10, pika 5.1) dhe lista e mentorëve që i plotësojnë kushtet për mentorim, me kapacitetet përkatëse, të dërgohet së bashku me kërkesën për konkurs dhe të bëhet publike për kandidatët.

Me respekt,

Prof. Dr. Blerim Rexha

Kryetar i Komisionit për shqyrtimin e ankesave

VIII. REFERENCAT

1. EUA (2005), Salzburg Principles — “Doctoral Programmes for the European Knowledge Society”; të përmbledhura në dokumentin Salzburg II:
<https://www.eua.eu/publications/positions/salzburg-ii-recommendations.html>
2. EUA (2010), “Salzburg II Recommendations — European universities’ achievements since 2005 in implementing the Salzburg Principles”:
<https://www.eua.eu/downloads/publications/salzburg%20ii%20recommendations%202010.pdf>
3. European Commission (2011), “Principles for Innovative Doctoral Training”, ERA Steering Group on Human Resources and Mobility, Bruksel, 27.06.2011:
https://euraxess.ec.europa.eu/sites/default/files/policy_library/principles_for_innovative_doctoral_training.pdf
4. European Commission (2005), “The European Charter for Researchers & The Code of Conduct for the Recruitment of Researchers”:
<https://www.cesaer.org/content/7-administration/legal-affairs/values/european-charter-researchers.pdf>
5. Council of Europe/UNESCO (1997), “Convention on the Recognition of Qualifications concerning Higher Education in the European Region” (Konventa e Lisbonës, ETS nr. 165): <https://rm.coe.int/168007f2c7>